



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VORË**

**DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vorë, me \_\_\_/\_\_\_/2018

**PLANI STRATEGJIK  
PËR ZHVILLIMIN PRONAVE PUBLIKE  
TË BASHKISË VORË**

**2018**

**QËLLIMI:** Nepermjet politikave te administrimit te arrihet menaxhimi publik i tyre duke maksimizuar perdorimin eficient te asetave publike ne varesi te funksionit te tyre vendor dhe me gjere, duke sherbyer per progres dhe zhvillim te qendrueshem.

**VIZIONI:** Te arrihet qe brenda territorit administrativ te identifikohen te gjitha asetet, gjendja e tyre, perdorimi, masat qe do te merren ne funksion te ruajtjes, administrimit dhe menaxhimit ekonomik per perfitim maksimal publik.

Asetet publike vendore jane pasuri e rendesishme natyrore dhe te inventarizuara ne vite, te cilat nga funksioni qe kryejne japin impaktin e vet te drejteperdrejte ose indirekt ne permbledhjen e funksioneve te njesise se qeverisjes vendore, te cilat jane objekt i ndertimit, planifikimit te politikave social-ekonomike per permiresimin e cilesise se jetes te banoreve brenda ketij territori administrativ. Per te njohur, evidentuar dhe katerizuar perdorimin e asetave ne lehtesimin e funksioneve te tyre sipas cilesise publike, po japim dhe planifikojme efektin, objektivat e menaxhimit te tyre per periudhen 2018-2023.

## **I- TERRITORI ADMINISTRATIV.**

Përbehet nga Bashkia Vorë, njesitë Prezë dhe Bërxull. Nga pikepamja e siperfaqes dhe perberja e pronave brenda tij, jepet si me poshte:

**-Njësia Prezë:** Administrojnë nje siperfaqe prej **2796 Ha**, nga e cila toke bujqesore **1403 Ha**, pyje **509.4 Ha** dhe toke jobujqesore (urbane dhe PF) respektivisht **336 Ha**

Ne analizen e perberjeve kadastrale me afat publik eshte fondi pyjor dhe ne raport me territorin perben **20%** te tij dhe pjesa tjeter **12%** perben toke jobujqesore, ne perberje te tij jane sistemet e rrugeve, banesave, shesheve, rrugeve nacionale dhe zona e banesave urbane.

**Njësia Bashkiake Vorë:** Administrojnë nje siperfaqe prej **3983.3 Ha**, nga e cila toke bujqesore **2428 Ha**, pyje **1005.85 Ha** dhe toke jobujqesore (urbane dhe PF) respektivisht **350 Ha**.

**Në analizën** e zerave kadastrale eshte fondi pyjor dhe ne raport me territorin perben **26%** te tij, e pjesa tjeter **9%** perben toke jo bujqesore. Ne perberjen e saj perfshihen zerat me perberje sistemet e rrugeve urbane dhe bujqesore, shesheve, rrugeve nacionale dhe zonat moçalishte dhe skeletike ne afersi te tokave bujqesore etj.

**Njësia Bërxull:** Administrojnë nje siperfaqe prej **1227.90 Ha**, nga e cila toke bujqesore **1027 Ha**, **20.22** pyje ha dhe toke jobujqesore (urbane dhe PF) respektivisht **117.6 Ha**.

Ne analizen e zerave kadastrale kadastrale ne raport me territorin eshte fond i tokes bujqesore qe ze perqindjen me te madhe te siperfaqes te territorit me **84%** te tij dhe pjesa tjeter **10%** perben toke jobujqesore. Ne perberje te tij jane sistemet e rrugeve, banesave, shesheve, rrugeve nacionale dhe zona e banesave urbane.

**Tabela mbi përdorimin e tokës bujqësore ne njesite Vore, Preze dhe Berxull.**

Nr	Fshati	Sipërfaqe totale (Ha)	Sipërfaqe bujqësore (Ha)	E ndarë në zëra				Pyje	Urbane	Jo bujqësore
				Arë	Ullish-te	Pemëtore	Vre shte			
1	Marikaj	1244.8	993	159	551	248	35	229.34	18	4.5
2	Marqinet	730.77	524.4	221	269	34.4	0	132.37	41	33
3	Gërdec	297.5	38.3	34.8	3.5	0	0	241.4	8	9.8
4	Shargë	218.7	109.5	74.5	12.1	22.9	0	34.41	35.8	39
5	Muçaj	303.6	280.8	181	47.8	52.1	0	0	10	11.8
6	Kodër-Vorë	111	83.9	36.6	17.3	30	0	0	13.5	13.5
7	Picar	246.5	201.1	154.3	8.54	38.3	0	0	7.8	37.6
8	Gjokaj	325.3	247.7	151.4	3.3	93	0	42.2	8.5	53.9
9	Kuç	506.2	151.7	23.8	100	5.2	0	350.56	3	1
	<b>Total Vorë</b>	<b>3983.3</b>	<b>2428</b>	<b>850</b>	<b>623</b>	<b>808</b>	<b>34</b>	<b>1005.85</b>	<b>145.6</b>	<b>204.1</b>
10	Palaq	931.88	472	317	83	60	12	341.88		118
11	Prezë	265.19	187	65	97	7	16	34.19	2	44
12	Ahmetaq	755.39	537	499	17	3	3	133.39	15	85
13	Gjeç Kodër	100	80	85	7	2	1	10.5	1.5	3
14	Fushë-Prezë.	539	487	452	15	-	-	42		3
15	Ndërmjet -ës	104.54	89.64	88	-	1	0.64	10	1.8	3.1
16	Breg Shkozë	100	95	87	5	3		3	1	1
17	<b>Total Prezë</b>	<b>2796</b>	<b>1403</b>	<b>924</b>	<b>623</b>	<b>166</b>	<b>17</b>	<b>509.4</b>	<b>37</b>	<b>299</b>
18	Bërçull	950.37	857					17.47	54	21.9
19	Domje	277.51	270					1.75	5.1	0.66
20	<b>Total Bërçull</b>	<b>1227.90</b>	<b>1027</b>	817	70	100	40	<b>20.22</b>	<b>87.6</b>	<b>30</b>
21	<b>Total Bashkia</b>	<b>8007.20</b>	<b>4858</b>	<b>2260</b>	<b>1148</b>	<b>537</b>	<b>48</b>	<b>1557.9</b>	<b>270.2</b>	<b>533</b>

**CFARË SYNOHET TË ARRIHET**

- 1- Evidentimi ne nje regjister ku te paraqitet gjendja e tyre, siperfaqe, perdorimi publik ose privat nepermjet procedurave te konkurrimit.
- 2- Ne varesi te pozicionit te tyre, te saktosohen ngastrat ne nje regjister, mundesite potenciale te tyre per prodhim bujqesor, per ullishtari, pemetore, arvore, agrume, vreshtari, toka bujqesore dhene me qera te treteve, si e vetmja mundesi e perdorimit te tyre.

3- Evidentimi dhe venia ne eficence e sistemeve kullues dhe vadites, rezervuareve se te zhvillimit bujqesor dhe blegtoral duke arritur ne njohjen dhe zgjidhjen e problemeve te atyre sistemeve te bllokuara 25 vjecare, me qellim perdorimin e tyre si burime natyrore.

## **SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE NË BASHKINË VORË**

**Ne zbatim** te programit te Qeverise, te cilat vene theksin ne nevojen urgjente te rishikimit te strategjise afatgjate te zhvillimit te Sektorit te Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Vore po punon per hartimin e nje strategjie me te gjere te ketij sektori. Rishikimi i strategjise se zhvillimit te Sektorit te Pyjeve dhe Kullotave kushtezohet nga situata e veshtire e ketij sektori e krijuar pas viteve '90. Aktiviteti i ketij sektori ka nevoje per ndryshime thelbesore si ne fushen e menaxhimit ashtu edhe ne ate te kontrollit ne perputhje me politikat e Qeverise per kete sektor dhe per mjedisin ne teresi.

Vendimi i fundit i qeverise, per te forcuar ruajtjen dhe funksionimin e te mirave publike te pyjeve dhe kullotave dhe ndalimin e perkohshem te shfrytezimit tregtar te burimeve pyjore, ben te nevojshme rishikimin dhe perditesimin e Strategjise per zhvillimin e sektorit te pyjeve dhe kullotave. Strategjia per Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave ka si qellim sigurimin e *menaxhimit dhe zhvillimit te qendrueshem* e shumefunksional te burimeve pyjore dhe kullosore ne perputhje me politikat qeveritare te synuara ne kete sektor.

Konservim i vazhdueshem, perdorimi racional dhe vleresimi i drejte i te mirave publike te eko-sistemeve pyjore dhe kullosore, ne perputhje me interesat e shtresave te ndryshme te popullsisë realizohet nepermjet nje qeverisje te qendrueshme e shumefunksionale. Ajo ka nevoje te koordinohet me strategjite globale dhe rajonale qe lidhen dhe kushtezohen me ruajtjen dhe mireadministrimin e qendrueshem te burimeve natyrore (pyjeve dhe kullotave). Strategjia e Zhvillimit te Sektorit te Pyjeve e Kullotave hartohet duke u mbeshtetur ne zhvillimet socialo – ekonomike te vendit, reduktimit te varferise ne zonat rurale, ndryshimeve thelbesore qe kane ndodhur e do te ndodhin ne drejtim te levizjeve demografike dhe nevojës per nje vleresim shumefunksional te burimeve pyjore e kullosore ku do te veçonim: pyjet si burim energjie, si burim i prodhimeve paresore dhe biomases, si burim i diversitetit biologjik dhe i sekuestrimit te karbonit etj.

Strategjia percakton linjat kryesore te sektorit ne 2 dekadat e ardhshme. Ajo perben nje program kombetar per pyjet dhe kullotat, nje pakete veprimesh qe do te zbatohen per 10 vitet e ardhshme, ne bashkepunim me partneret.

**GJENDJA E PËRDORIMIT TË PYJEVE PARAQITET NË TABELËN E MËPOSHTME:**

Nr	Fshati	Sip. pyjore (Ha)	Trung -ishte (Ha)	Mënyra e përdorimit (Ha)			Cungishte (Ha)	Mënyra e përdorimi (Ha)			Shkurre (Ha)	Mënyra e përdorimit (Ha)		
				Përb-ashkët	Fise	Familjare		Përbashkët	Fise	Familjare		Përbashkët	Fise	Familjare private.
1	Marikaj	229.34	-	-	-	-	-	-	-	-	229.34	-	229.34	-
2	Marqinet	132.37	-	-	-	-	14.34	-	14.34	-	118.03	-	118.03	47
3	Gërdec	241.40	-	-	-	-	90.11	-	90.11	-	151.29	-	151.29	-
4	Shargë	34.41	14.23	-	14.23	-	-	-	-	-	20.18	-	20.18	-
5	Gjokaj	42.20	-	-	-	-	5.78	-	5.78	-	36.42	-	36.42	-
6	Kuç	350.56	-	-	-	-	49.02	-	49.02	-	301.54	-	301.54	-
7	Palaq	341.88	102.83	-	102.83	-	50.44	-	50.44	-	188.61	-	188.61	-
8	Prezë	34.19	15.51	-	12.51	-	-	-	-	-	21.68	-	21.68	-
9	Ahmetaq	133.39	133.39	-	133.39	-	-	-	-	-	-	-	-	-
10	Gjeç Kodër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
11	Fushë-Prezë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
12	Njësia Bërxull	20.22	-	-	-	-	-	-	-	-	20.22	-	20.22	-
	<b>TOTALI</b>	<b>1557.9</b>	<b>265.96</b>	-	<b>262.96</b>	-	<b>209.69</b>	-	-	-	<b>1087.32</b>	-	-	<b>47</b>

**ANALIZE:** Nga te dhenat e mesiperme rezulton se 20% e sipërfaqes totale te Bashkise Vore jane pyje, nga keto 17% jane trungishte, 13% cungishte dhe 70% jane shkurre.

**1. STRATEGJIA E SEKTORIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.**

**Strategjia** e sektorit te pyjeve dhe kullotave perben nje dokument qe percakton drejtimet strategjike afatgjata per zhvillimin e ketij sektori. Per permbushjen e objektivave strategjike, te misheruara ne planin e veprimit synohet ruajtja dhe rivendosja e ekuilibreve natyrore te burimeve pyjore e kullosore, administrimi i qendrueshem i sistemeve te prodhimit pyjor e kullosor si dhe arritja e nje kontributi optimal te Sektorit te Pyjeve dhe Kullotave ne rritjen e pergjitheshme ekonomike, luftimin e varferise dhe zhvillimin e qendrueshem.

Kjo strategji ka nje rendesi te vecante sepse:

- **Jep** orientimet baze te zhvillimit te strukturave administrative, institucioneve politike dhe organeve qe do te udheheqin zbatimin e programeve te zhvillimit te ketij sektori.
- **Thekson** lidhjet dhe rendesine themelore te sektorit te pyjeve dhe kullotave per plotesimin e objektivave te zhvillimit te bujqesise, blegtorise, ujerave, turizmit, zhvillimit rural ne pergjithesi, duke mundesuar permiresimin e planifikimit ndersektoral dhe e koordinimit te programeve te zhvillimit te vendit.
- **Kontribuon** ne rritjen e vetedijes se autoriteteve te larta vendim-marrese e administrative, komuniteteve te perdoruesve te burimeve natyrore, pyjore e kullosore, e publikut ne pergjithesi, per nje kuptim me te qarte lidhur me kontributin e mundshem te

Sektorit Pyjor e Kullosor ne zhvillimin e pergjithshem, per ta mbeshtetur ate me politikat, autoritetin dhe burimet financiare te nevojshme.

- **Duke** konsideruar veten si aktor dhe faktor te perpjekjeve dhe nismave per zhvillimin e sektorit pyjor e kullosor, personeli pyjor do te angazhohet ne nje veprimtari me te pergjegjeshme dhe me profesionale.
- **Kontribuon** ne kapercimin e veshtiresive qe pengojne sektorin privat ne ndermarrjen e investimeve pozitive dhe nxit ndermarrjen e sigurte nismave qe kane te bejne me ruajtjen dhe qeverisjen e qendrueshme te burimeve natyrore, pyjore e kullosore.
- **Siguron** nje kuader legjislativ, vleresimi e monitorimi qe te lejon matjen dhe sipas rrethanave ndryshimin e qeverisjes, bazuar ne ecurine progresive dinamike dhe ne arritjen e synimeve politike.

**Mbrojtja e burimeve natyrore** dhe e natyres ne teresi, ka perbere prej disa dhjetra vjecaresh nje argument te rendesishem per mbare boten e qyteteruar. Kjo deshmohe me numrin e madh te konventave te nenshkruara nga shumica e shteteve te botes nder te cilat edhe Shqiperia. Keshtu mund te permendim Konventen e Diversitetit Biologjik (KDB) te vitit 1994, strategjine Pan – Europiane te Diversitetit Biologjik dhe te pejsazheve (SPEDBP) te cilat bejne fjale per ruajtjen dhe menaxhimin e diversitetit biologjik e te resurseve gjenetike. Euromontana e vitit 1998 qe percakton parimet e nje politike te qendrueshme pyjore e kullosore ne lidhje te ngushte me zgjidhjen e kerkesave te popullsise rurale, Axhenden 2000 e cila jep orjentimet baze per nje Politike Bujqesore Komunitare me te blerte etj. Ne hartimin e kesaj strategjie eshte mbajtur parasysh qe idete e saj te jene ne pershtatje me idete themelore te konventave nderkombetare.

## **2. PERCAKTIMI I PRIORITETEVE.**

**Pyjet** dhe kullotat perbejne nje trashegimi me vlere jo vetem per Njesine tone Bashkiake, por per tere Shqiperine, rajonin e me gjere. Ajo duhet te mbrohet dhe qeveriset ne menyre te tille qe te mundesoje nje zhvillim me te madh ekonomik ne te ardhmen, duke kontribuar ne uljen e nivelit te varferise, pa prishur ekuilibret biologjike natyrore. Ne te kaluaren perfshire dhe vitet e tranzicionit, sidomos pyjet jane vleresuar per rendesine ekonomike, duke nenvleftesuar aspektin shumefunksional te tyre. Vecse shfrytezimi i tyre nuk çon vetem ne fitime por edhe ne humbje (kur nuk shfrytezohe drejt) si rezultat i humbjes se mundesive per zhvillim ne te ardhmen, rrjedhoje e degradimit e desertifikimit te mjedisit pyjor e kullosor. Menaxhimi i qendrueshem i resurseve natyrore te pyjeve dhe kullotave nenkupton mireqeverisjen dhe perdorimin e resurseve ne nje menyre dhe me nje ritem qe ruan dhe siguron biodiversitetin, prodhimtarine, aftesine ripertesese, vitalitetin dhe potencialin e tyre per te permbushur, per sot dhe te ardhmen, funksionet ekologjike, ekonomike dhe sociale ne nivel lokal, kombetar dhe global, pa shkaktuar deme ne ekosisteme te tjera.

Koncepti i menaxhimit te qendrueshem te burimeve natyrore ne pyje dhe kullota eshte ne thelb i njejte me konceptin e pergjithshem te te qenurit i qendrueshem.

Zhvillimi i qendrueshem eshte ai zhvillim, i cili:

- **Integron** procesin e planifikimit te vlerat ekonomike, mjedisore dhe shoqerore.
- **Shperndan** ne menyre te njejte dhe te barabarte perfitimet qe rrjedhin prej ketij zhvillimi sipas shtresave social-ekonomike dhe gjinise.
- **Siguron** te pakten te njejtat mundesi per nje zhvillim te vazhdueshem edhe per brezat e ardhshem.

Termi "zhvillim i qendrueshem" eshte produkt i iniciativave nderkombetare qe lidhen me Samitin e Tokes (Rio, Qershor1992) dhe Zhvillimin e Qendrueshem ne vijim te tij. Ky term eshte percaktuar dhe shtjelluar me tej nga nje varg procesesh rajonale dhe nderkombetare ne te cilat jane perpunuar kriteret dhe indikatoret te nje zhvillimi dhe menaxhimit te qendrueshem. Per te realizuar kete koncept, ne stadin aktual kerkohet te mbahen parasysh keto perparesi:

- **Nderprerja** e biznesit te shfrytezimeve tregetare per nje periudhe te pakten 10 vjecare nepermjet riorganizimit dhe rritjes se kontrollit. (Shfrytezimet vazhdojne te kryhen vetem ne ata grumbuj pyjore qe kane te nevojshem trajtimin me prerje per sigurimin e riprteritjes natyrore.)
- **Ruajtja** dhe rehabilitimi i pyjeve dhe kullotave nepermjet rritjes se investimeve dhe nxitjes se iniciativave private e kolektive.
- **Qeverisja** e qendrueshme e pyjeve dhe kullotave, nepermjet nje strategjie per nje mbeshtetje te organizuar te produkteve pyjore, ne te gjitha nivelet.
- **Vendosja** e nje sistemi monitorimi per ndjekjen ne kohe te proceseve dinamike ne pyje dhe kullota dhe per nderhyrjen ne kohe per rehabilitimin e tyre.
- **Nxitja** e nismave individuale ose kolektive per ripyllimin e tokave te zhveshura dhe te abandonuara.
- **Ruajtja**, mbrojtja dhe permiresimi i diversitetit biologjik ne ekosistemet pyjore dhe kullosore.
- **Ruajtja** dhe permiresimi i pershtateshem i funksioneve mbrojtese ne mbareshtimin e pyjeve dhe kullotave (ne menyre te vecante mbrojtjen e tokes, te sasisve dhe cilesise se ujrave).
- **Ruajtja** e funksioneve dhe sherbimeve te tjera social-ekonomike, si dhe sigurimi i perfitimeve te shumefishta per shoqerine, per brezat e sotem dhe te ardhshem.

Zbatimi i nje sere konventash nderkombetare me objektiva ne mireperdorimin dhe ruajtjen e pyjeve e kullotave mund te arrihen vetem nepermjet pranimit dhe respektimit te parimeve te ruajtjes dhe zhvillimit te praktikave te nje zhvillimi te qendrueshem te gjithe sektoreve qe lidhen me to.

### 3. PARIME STRATEGJIKE

QEVERISJA E QENDRUESHME E BURIMEVE PYJORE E KULLOSORE.

Kjo buron nga:

- Nevoja e nje **vleresimi** me te mire te burimeve pyjore e kullosore ne aspektin shumefunksional.
- Nevoja e rritjes se shtresave te popullsise te interesuara per mirembajtjen e **mireqeverisjen** e pyjeve dhe kullotave.
- Nevoja e nje lufte me efikase ne drejtim te uljes se shkalles se **erozionit** dhe desertifikimit.
- Nevoja e **ruajtjes** dhe perdorimit efikas te burimeve ujore.

NDARJA E DREJTE E PERFITIMEVE DHE DOBIVE QE VIJNE NGA MBROJTJA DHE PERDORIMI I BURIMEVE NATYRORE, PYJORE E KULLOSORE.

Kjo buron nga:

- **Nevoja** e rritjes se numrit te familjeve qe perfitojne nga te ardhurat pyjore e kullosore me qellim luftimin e nivelit te varferise.
- **Nevoja** e perdorimit, e ruajtjes se traditave, e kultures ne drejtim te mireadministrimit te pyjeve.
- **Nevoja** e ndryshimit te struktures se pyjeve e kullotave lidhur **me pronesine**, drejt niveleve te vendeve te tjera te perparuara.
- **Nevoja** e lenies si trashegimi per brezat e ardhshem te nje ekonomie pyjore e kullosore vitale e te shendetshme.

### 4. SYNIMET STRATEGJIKE AFATSHKURTËR TË NJESISË BASHKIAKE VORË

**Sigurimi i integritetit territorial, ekologjik dhe biodiversitetit te pyjeve dhe kullotave.**

**Mbrojtja** e pyjeve permes ndalimit te shfrytezimit, kombinuar me marrjen e masave per restaurimin, ruatjen dhe permiresimin e biodiversitetit (ruajtja e pyjeve dhe tokave pyjore, permiresimi i funksioneve per mbrojtjen e tokes nga erozioni dhe te ujerave, nderhyrjet permiresuese ne kullota).



**Objektivi 1.** *Konservimi i pyjeve nepermjet prerjeve ilegale pa perjashtuar prerjet kulturore te te gjitha llojeve per furnizimin me dru zjarri te popullates (prerjet rehabilituese te kontrolluara).*

**Ku synohet:**

- **Nderprerja** e shfrytezimeve tregtare per 10 vjet (sipas ligjeve ne fuqi).
- **Ulja** sa te jete e mundur me shume e nivelit te prerjeve ilegale.
- **Ruajtja** e pyjeve te virgjër ose pothuajse te virgjër duke kaluar ne konservimin e plote te tyre (**kategoria e pyjeve te ruajtura, te investuara, te administruara**).

**Objektivi 2.** *Ruajtja dhe rehabilitimi i ekosistemeve pyjore e kullosore te demtuara e ne degradim (ruajtja e specieve autoktone si Marea, Frasheri, Ilqeri, Dushqe, etj).*

- **Organizimi** i punes ne menyre te tille qe e gjithë siperfaqja e pyjeve te pershkohen nga prerje kulturore sipas fazes se zhvillimit ne te cilen gjendet dhe kerkesave te silvikultures per fazen perkatese, (**te legalizohet prerja per furnizimin me dru zjarri ne tre mujorin e pare dhe te katert te cdo viti**).
- **Gjetja** e sponsoreve per ripyllezimin e siperfaqeve te pa riparterira brenda pyjeve me qellim perdorimin e gjithë siperfaqes nga pylli prodhues.
- Gjetja e sponsoreve dhe **pyllezimi** i siperfaqeve te zhveshura me lloje pioner (pyje te rinj) per te rritur kapacitetin e sekuestrimit te karbonit nga siperfaqja e territorit te Njesise tone Bashkiake, (**druret halore**).
- **Rehabilitimi** i kullotave me mbjellje foragjere e drusore sipas shkalles se pjellorise ne te cilen gjenden, (te evidentohen tokat pyjore te zhveshura brenda parcelave pyjore me qellim perdorimin e kulturave bujqesore per blegtorine).
- Planifikimin e ndertimit te **fidanishteve pyjore** per nevojat e pyllezimeve te reja te Fondit Pyjor te Bashkise, ku do te behen nderhyrje me pyllezime,
- Hartimi i **Planit te Menaxhimit te Pyjeve**, Livadheve e Kullotave per dhjetevjecarin 2018-2028, (bashkepunim me Ministrine e Mjedisit per pregatitjen e ketij plani).
- **Evidentimi brenda parcelave** te grumbujve pyjore te unifikuar pa nderhyrje me qellim ruajtjen e tyre si potencial prodhimi drusor duke kontrolluar prerjet e paligjshme per nje periudhe 10-te vjecare, duke sherbyer si modele te pyjeve te ruajtur dhe te mbrojtur, (zona e Kucit, Picar, Gjokaj, Marikaj, Gerdec).

## **5. SYNIMET STRATEGJIKE AFATMESME TË NJËSISË BASHKIAKE VORË**

### **1. Organizimi i një kadastre pyjore moderne si bazë për ruajtjen e tërësisë së fondit pyjor.**

**Objektivi 1.** *Perfundimi dhe implementimi i te dhenave te Inventarit te Pyjeve, krijimi i nje Regjistri te modeluar nga Ministria e Mjedisit per gjendjen aktuale te pyjeve, llojet e tyre, ndryshimet qe peson parcela pyjore nga nderhyrjet, qeraperdorjet, etj, me qellim*

*administrimin ligjor per cdo parcele pyjore ne territorin e Bashkise Vore, (te dhena mbi azhornimin e Kadastres Pyjore).*

- **Hartimi** i projekteve teknike të ekonomive pyjore sipas zonave me qëllim investimet ne parcelat pyjore me prioritet ato te degraduara nga nderhyrjet e paligjshme per pyllezimin e tyre me specie autoktone, anti erosive, me qëllim mbulimin me mase pyjore te ketyre parcelave.

- **Legalizimi perdoruesve te pyjeve** (popullata) nepermjet kontratave te perdorimit per te kontrolluar dhe administruar parcelen pyjore si njesia baze e kadastres, me qëllim kontrollin e prerjeve te lejuara per furnizimin me dru zjarri, prodhimet e dyta pyjore dhe jopyjore (bime mjekesore tanifere, humus per bujqesine, prodhimin e qymyrit, deri te mbareshtimi i kafsheve te egra).

**Objektivi 2.** *Organizimi i nje kadastre pyjore moderne.*

- **Të pregatitet**, te rakordohet me Ministrine pergjegjese dhe te behen trajnime per personelin e Sektorit te Pyjeve prane Bashkise Vore, me specialiste te fushes, me pervoje te gjate ne administrimin dhe menaxhimin e pyjeve me qëllim krijimin e nje kadastre perfekte , te menaxhueshme duke pajisur sektorin me tekniken modern te sistemit dixhital te hartave pyjore (sistemi GIS etj).

## **2. Permiresimi i menaxhimit te zonave te mbrojtura.**

**Objektivi 1.** Te krijohet brenda sistemit te pyjeve ku do te konsistohet ruajtja mbi 10-te vjet per mosnderhyrje, te cilat do te sherbejne si modele te parcelave pyjore me efekte te medha nga pikepamja ekonomike (volumi i prodhimit drusor), mjedisore, nga pikepamja e fikesimit te CO<sub>2</sub>, dhe gjithashtu rekreative per banoret me prioritet zhvillimin e ekoturizmit, (synohen parcelat mbi rezervuaret ne vijimesi te zonave urbane, etj). Zona e Marqinet-Sharge, Picar-Gjokaj-Marikaj dhe Ahmetaq, njesia Preze (lumi Gjola ne gjatesine 15 km).

- **Të hartohet** një projekt-plan (pjesë e studimit te projektit), i cili të përfshijë parashikime buxhetore për menaxhimin efektiv dhe zhvillimin eventual të sistemit të zonave të mbrojtura, duke identifikuar zonat me prioritet më të lartë dhe kriteret për klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, me qëllim që të tërhiqet vëmendja për gjendjen, si dhe të përcaktohen hapat dhe afatet për realizimin e tij.

- **Përgatitja** e planeve të menaxhimit për Zonat e Mbrojtura (parcelat 26,27,28, 29, 30, 31 Marqinet, me sip.140.05 Ha)me perparesi ne ato më të ndjeshme dhe të rëndësishme nga pikepamja ekonomike dhe financiare e vleres se projektit dhe perfitimeve vondere nga shfrytëzimi dhe prokurimi i ketyre zonave.

- **Të vlerësohen** efektet e zbatimit të planeve të mbarështrimit nepermjet nje analize te pergjithshme, efektet positive te tij, ne administrimin dhe menaxhimin e Fondit Pyjor, lidhur me njohjen dhe perdorimin e pyjeve dhe kullotave ne pronesi te Bashkise Vore,

per te filluar ne vitin 2018-te planifikimin ne buxhet te ardhurat qe do te sigurohen nga Fondi Pyjor, duke e shtrire studimin deri ne vitin 2023.

- **Të identifikohen** parcelat pyjore me probleme sis rezultat i nderyrjeve ne vite, nga banoret, ndryshimi i pjesshem i destinacionit te tyre (troje per banesa dhe ngrehina bujqesore, mbjellja e kulturave bujqesore (pemetari dhe ullinj), identifikimi i personave pergjegjes, masat per rehabilitimin e tyre dhe per pasoje ndryshimi qe do te behet ne Kadastrin Pyjore per keto parcela).
- **Te studiohet** i gjithe rrjeti rrugor qe lidh parcelat pyjore me njera-tjetren me qellim qarkullimin e mjeteve dhe njerezve per rritjen e sasise se mbareshrimeve, gjithashtu per ruatjen nga zjarri ne periudhat e thata te veres, per levizjen e zjarrfikeseve dhe mjeteve te tjera, si rezultat i renies se zjarreve eventuale. Duke planifikuar dhe fondet e pastrimit dhe krijimit te rrugeve lidhese.
- **Të krijohet sinjalistika pyjore** nepermjet vendosjes se tabelave ku te skedohen numri i parces pyjore, vendodhja, siperfaqja, lloji perberes i bimesise pyjore, duke i vendosur ne vende te dukshme identifikuese ne lartesine e sistemit te kodrave te cilat ndajne edhe territoret administrative ndermjet njesive te tjera dhe qarqeve te Prefekturave, gjithsej 65 tabela per parcelat pyjore Vore, Preze dhe Berxull.

**Objektivi 2.** *Ngritja e administratave te zonave te mbrojtura dhe trajnimi i tyre, zonat natyrore te menaxhuara si dhe pejsazheve te mbrojtura, me qellim zhvillimin dhe zbatimin e planeve te menaxhimit permes nje pjesmarrje sa me te gjere te komuniteteve vendase në to.*

- **Të vlersohen** infrastruktura, pajisjet, materialet, personeli dhe nevojat financiare dhe ato për kualifikim e trajnim të nevojshme për të arritur një nivel optimal për ruajtjen e zonave të mbrojtura të konsideruara si prioritare.
- **Ngritja** sa me shpejte e administratave dhe autoriteteve menaxhuese të zonave të mbrojtura.
- **Të hartohen** dhe zbatohen programe per organizimin e fushatave te ndërgjegjësimit ne nivel ne nivel vendor, për të informuar publikun për rëndësine, vlerat dhe dobitë e ketyre zonave.
- **Të programohen** dhe zbatohen kurse kualifikimi special për specialistet e Sektorit te Pyjeve duke rakorduar me Ministrine e Mjedisit Tirane, ish-Inspektoriatin Shteteror te Mjedisit, me qellim pregatitjen e nje personeli te kualifikuar per administrimin dhe menaxhimin e pyjeve vendore.
- **Të shfrytëzohet** mbështetja e organizatave jo-fitimprurese që kanë interes për zonat e mbrojtura dhe të vendosen marrëdhënie të duhura pune me to në fushat e rritjes së ndërgjegjësimit publik, edukimit për mjedisin, dhe shërbime vullnetare jo-teknike (fushata kundër ndotjes, studime ekologjike, duke rakorduar me ata dhe perfituar mjete material dhe financiare, etj).

## 6. SYNIMET STRATEGJIKE AFATGJATA TË NJESISË BASHKIAKE VORË

### 1. Ruajtja e natyres dhe promovimi i parcelave pyjore nepermjet marredhenieve kontraktuale.

**Objektivi 1.** *Hartimi i nje plani vendor afatgjate me objektiv ku do te synohet evidentimi i gjendes aktuale e pyjeve si rezultat i zbatimit te planeve te meparshme afatmesme, efektet e tyre ne zhvillimin e qendrueshem te pyjeve ku eshte synuar ndalja e degradimit, intensifikimi i investimeve dhe planifikimi i perfitimeve ekonomike, sociale, nga perdorimi ekonomik i parcelave pyjore ne te gjithë elementet e tyre (treguesit e prodhimit per te arritur volumin e prodhimit drusor prej rreth 4000m<sup>3</sup> dru zjarri , treguesit e mjedisit dhe ato ekonomiko-financiar prej rreth 3-5 milion leke).*

- Ne fukcion te studimit te krijohet nje grup pune për të hartuar një Plan Vendor për **zhvillimin e turizmit** në pyje e kullota. Ky plan duhet te perfshije zhvillimin e turizmit edhe ne disa kategori zonash pyjore, ku sipas ligjit lejohet zhvillimi i aktiviteteve shlodhese dhe rekreative, si parqet vendore, zonat e pejsazheve te mbrojtura dhe zonat e resurseve te menaxhuara, te pershkruara me lart ne vijimesi te rezervuareve dhe sistemeve te kodrave.

- **Te behet** ne menyre me profesionale per sa me lart, puna per promovimin e turizmit dhe ekoturizmit brenda dhe ne afersi te zonave te mbrojtura, si nje burim i rendesishem i sigurimit te te ardhurave per komunitetet qe jetojne prane ose brenda zonave te mbrojtura rekreative, etj.

- **Te vendosen** kontakte me te mira pune dhe bashkepunimi me **agjensite** vendase dhe te huaja turistike qe operojne ne vendin tone, per promovimin e ekoturizmit ne zonat natyrore pyjore te Bashkise me qellim shprehjen e interesit nga ato, per perdormin e parcelave pyjore me destinacion ekoturizmin, turizmin familjar, etj. Vazhdimisht ne ëbsite e Bashkise te promovohen parcela te destinuar per kete qellim nga Drejtoria i **Pronave dhe Sektori i Informimit.**

**Objektivi 2.** *Pjesmarrja e njesise vendore dhe aktoreve te tjere per mbeshtetjen dhe zhvillimin e infrastruktures se kreditimit per turizmit privat.*

- **Të hartohet** një model për dhënien e konçesioneve sipërmarrësve të sektorit privat që janë të interesuar të sigurojnë shërbime turistike, çlodhëse dhe argëtuese në natyrë.

- **Bashkia** te shohe me perparesi permiresimin dhe **zhvillimin e infrastruktures** ne zonat me perparesi turizmin duke investuar ne infrastrukturen rrugore pa te cilen s'mund te kete zhvillim te asnje alternative turizmi. Ne kete kendveshtrim ajo duhet te nxise siper marrjen private për te investuar ne fushen e turizmit.

## 2. Përmirësimi i organizimit të procesit të prodhimit pyjor në pyje.

**Objektivi** . *Formimi i njesive te reja te prodhimit per pyjet prodhues.*

- Organizimi i masiveve pyjore me pyje të lartë në njësi prodhimi, me synim sigurimin nga secila prej tyre të vazhdimësisë të procesit të prodhimit pyjor ne nivel vendor.
- Hartimi i planeve te mbarështrimit te këtyre njesive të prodhimit dhe rimbareshtimi duke parashikuar shfrytëzimet te pakten për një periudhë 10- vjeçare mbi bazën e parimit të vazhdimësisë.
- Vjelja e produkteve pyjore te njesive të prodhimit nga firmat private, për llogari të drejtorive të cilat paguajnë firmat për punën e kryer por ndermarrjet mbeten zoterues te produkteve (per lenden ankand ne ane te rruges).
- Hartimi të planeve të mbarështrimit të pyjeve prodhues, të pyjeve komunalë, kullotave si dhe te pyjeve private ne funksion te pageses, qe mund te jete e njejte per njesi siperfaqe me ate te pyjeve shteterore (aktivitet i perhershem).
- Pasqyrim i ndryshimeve në kadastrën pyjore (aktivitet i përhershëm)
- Hartimin e projekteve të fushave të ndryshme të pyjeve ( sipas gjëndjes së investimeve që jepen ) me specialistët e vet ose të jashtëm të angazhuar me kontratë

## 3. Nxitja e perdorimit multifunksional te burimeve pyjore dhe kullimore.

**Objektivi 1.** *Promovimi i funksioneve sociale dhe mbrojtese te pyjeve.*

- **Promovimi** i funksionit social te pyjeve dhe kullotave lidhur me mbrojtjen e shendetit publik, mbrojtjen e ujrave, tokes dhe ajrit.
- **Promovimi** i funksioneve mbrojtese te pyjeve dhe kullotave nga erozioni dhe rreshqitja e tokes, ererat dhe permbytjet duke i paraprire me studime konkrete per kete ceshtje ne varesi te fenomeneve te erozionit ne parcelat pyjore.
- **Rritjes** se efekteve mbrojtese te pyjeve nga ndotjet e tokes, ajrit dhe ujrave.
- **Promovimi** i efektit mbrojtës te pyjeve per qendrat e banuara, infrastrukturave te transportit, energjise dhe furnizimit me uje, monumenteve natyrore dhe kulturore.

**Periudha 2019-2028, (Vazhdimisht per cdo vit).**

- **Promovimi** i vlerave çlodhese dhe rekreative me perparesi zhvillimin e turizmit kulturor dhe familjar. **(Vazhdimisht per cdo vit).**

**Objektivi 2.** *Promovimi i potencialit prodhues per prodhimet jo drusore.*

- **Studimi** dhe promovimi i potencialeve prodhuese te pyjeve dhe kullotave ne bime mjeksore dhe tanifere, si rezerva te medha te pashfrytezuara deri tani si burim i konsiderueshem i te ardhurave qe nxirren nga Fondi Pyjor. **Periudha 2019-2028,**
- **Studimi** i popullatave te kafsheve te egra **objekt gjuetie dhe rekereacioni** per promovimin e flores dhe faunes vendore dhe mundesite e ngritjes te nje parku te

promovuar per mbareshtimin e kafsheve te egra te vizitueshme nga turistet. **Ne vijimesi me Ministrine e Mjedisit.**

• Studimi i mundesive mbajtese te fondit pyjore dhe kullosore per nxitjen dhe zhvillimit te sektorit te **bletarise** nga Sektori Publik ne partneritet me Sektorin Privat dhe vendosja e tarifave perkatese te mbareshtimit. **Periudha 2019-2022**

#### **4. Perdorimi i qendrueshem i masiveve kullosore si baze ushqimore per blegtorine e imet.**

**Objektivi 1.** *Studimi dhe percaktimi i gjendjes, sistemeve te perdorimit, administrimin e qendrueshem te integruar e multifunksional te kullotave, gjendja e tyre fizike, siperfaqja perkatese dhe mundesite potenciale si burime kullosore.*

• **Studimi** i gjendjes dhe kapaciteteve mbajtese te masiveve kullosore publike dhe komunale, evidentimi numerik i blegtorise se imet ne siperfaqen kullosore, mundesite e saj si burim ushqimor, kontrolli i kullotjeve pa cenuar zhvillimin e qendrueshem te rritjes se tyre. • **Studimi** dhe percaktimi i sistemeve te perdorimit te kullotave natyrore dhe mbi kete baze i menyres se qeverisjes dhe caktimi i tarifave per njesi (krere) te instaluara brenda parcelave pyjore ose ne kufi me to.

#### **5. Perfshirja e aktoreve dhe perdoruesve lokal ne ruajtjen dhe zhvillimin e pylltarise.**

**Objektivi 1.** *Rritja e numrit te familjeve qe perfitojne nga produktet e pyjeve, nga transferimi i se drejtes se perdorimit/pronesise te siperfaqeve te caktuara pyjore.*

**Objektivi 2.** *Plotësimi i nevojave të popullsisë rurale me dru zjari e lëndë ndërtimi.*

• Në bazë të politikës demografike të shtetit, Pushteti Vendor percakton dinamikën e nevojave për **dru zjarri** e lëndë ndërtimi për zonat rurale si dhe mënyrën e plotësimit të tyre. (Vazhdimisht).

• **Studimi** i potencialit të pyjeve komunale prodhuese për dru zjarri dhe lëndë ndërtimi dhe mundesite e shtimit te te ardhurave nga keto aktivitete.

**DREJTORI I DREJTORISË SË PRONAVE PUBLIKE DHE ADMINISTRIMIT  
TË PYJEVE**